



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1165 prot.

Tiranë, më 14. 08. 2020

Lënda: Dërgohet Rekomandim për marrjen e veprimeve pozitive, në pikat kufitare, duke i dhënë përparësi: të moshuarve, fëmijëve, personave me gjendje të renduar shëndetësore, personave me aftësi të kufizuara dhe grave shtatzëna.

MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME

Bulevardi: “Dëshmorët e Kombit”

Tiranë

MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Bulevardi: “Zhan D'Ark”

Tiranë

Për dijeni: KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Bulevardi: “Dëshmorët e Kombit”

Tiranë

TIRANE

Tënderuar,

Në kuadër të:

- ✓ ushtrimit prej Komisionerit për Mbrotjen nga Diskriminimi, me statusin e institucionit të pavarur publik, të atributeve që i jepen prej Ligjit nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për mbrotjen nga diskriminimi”, për të siguruar mbrotje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin;

- ✓ zbatimit të nenin 32, pika 1, germa “ë”, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010, i cili parashikon:

“Komisioneri ka kompetencë t'u bëjë rekomandime autoriteteve kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjisacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjisacionit ekzistues”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashtron këtë rekomandim, duke marrë shkas nga situata e krijuar ditët e fundit, në pikat kufitare të kalimit mes vendit tonë dhe shtetit Grek, dhe që vijon aktualisht, si pasojë e:

- Kufizimeve në sportelet e pikave kufitare, ku sipas burimeve mediatike jemi vënë në dijeni për pasjen e vetëm një ose dy sportelevë të cilët gjithashtu, punojnë më orare të kufizuara, pa marrë në konsideratë gjendjen e krijuar me radhë kilometrike dhe me qindra mjete në pritje të kalimit në pikat kufitare. Veçanërisht, situata rezulton e rënduar në pikat kufitare të Kakavijës dhe Kapshticës.
- Masës së vendosur nga shteti fqinj për karantinim, duke filluar data 16 gusht 2020, për personat që kalojnë pikat kufitare pas kësaj date. Kjo ka shkaktuar dhe nxitjen e shtetasve që kërkojnë kalimin e pikave kufitare përpara kësaj date, duke shkaktuar fluks të shtuar dhe vështirësi në menaxhimin e situatës.

Aktualisht, në pikat e kalimit kufitar, qytetaret janë në kushte të vështira, si pasojë e temperaturave shumë të larta, pa shërbime jetike dhe të nevojshme higjeno-sanitare dhe në kushte të një ndikimi negativ psikologjik, për shkak te situatës se pandemisë.

Ndodhur në kushtet e mësipërme dhe në zbatim të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, konkretisht, bazuar në nenin 11 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohen “Veprime pozitive”, sipas të cilit: *“Masa e përkohshme, e veçantë që synon pëershpejtimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, sipas këtij ligji. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe ofrimit të mundësive të barabarta”*, ju drejtohemë më këtë Rekomandim për marrjen e masave të përkohshme dhe të veçanta, duke i dhënë përparësi: të moshuarve; fëmijëve; personave me gjendje te renduar shëndetësore; personave me aftësi të kufizuara; grave shtatzëna, të cilët janë më vulnerabël dhe që për pasojë nevojitet një trajtim i veçantë në këto kushte të vështira.

Sa më lart, bazuar në nenin 32, pika 1, germa “ë”, të ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi:

R E K O M A N D O N :

- Marrjen e masave të menjëhershme, nga ana e autoriteteve shtetërore përgjegjëse, nëpërmjet veprimeve pozitive, duke i dhënë përparësi në kalimin e kufirit: të moshuarve, fëmijëve, personave me gjendje të rënduar shëndetësore, personave me aftësi të kufizuara si dhe grave shtatzëna.

Lutemi marrjen e masave për zbatimin e këtij rekomandimi, në përbushje të detyrimeve ligjore në fuqi, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe mos-diskriminimit.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin Tuaj,

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Në mungesë dhe me Urdhër
DREJTORE JURIDIKE



